



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

P.nr. 478/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoreshen profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në lëndën penale kundër të pandehurit L.V...nga fshati Ll..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilin e mbron sipas autorizimit av. Ramadan Leka, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.992/2023, të datës 10.07.2023, të cilën e përfaqëson Prokurorja e Shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së seancës fillestare dhe publik, më datën 24.07.2023, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri L.V..., i biri i F... dhe nënës N..., e lindur Sh..., i lindur me datë ..., në Gj..., me vendbanim në fshatin Ll..., komuna e Gj..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, me numër personal ..., me numër të telefonit 049/..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pavërtetuar deri me datë 26.06.2023, në Q.T “Viva Fresh Store”, në njësinë nr.2 në Gjilan, i pandehuri L.V..., në cilësinë e menaxherit, ka keqpërdorur autorizimet e tij që dalin nga kontrata e lidhur me ndërmarrjen “Viva Fresh Store”, me qëllim që vetit apo personit tjetër të i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka dëmtuar kompaninë në vlerë financiare prej 5,588.93 euro, ku gjatë përfaqësimit, apo kujdesit, për interesat pasurore të Viva Fresh Store, nuk i ka përmbushë detyrimet e tij, i ka keqpërdor, ashtu që artikujt e blerë nga konsumatorët, fillimisht janë regjistruar nga i njëjti, por për të përvetësuar paratë për nevojat e tij personale, nuk e kishte printuar fare kuponin fiskal, që ishte detyrë dhe obligim i tij, por kishte përdorur kartelën “0” për të shlyer artikujt që ishin blerë për konsum dhe këto mjete financiare, i kishte përvetësuar për nevoja personale apo përfitime personale, me ç rast të dëmtuarës ndërmarrjes “Viva Fresh Store”, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të 5,588.93 euro.

-Me çka ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s. Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 40, 42, 44, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK-s, si dhe 364 të KPP, të akuzuarin.

E G J Y K O N

- I.** Të akuzuarin **L.V...**për veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,
- II.** Në bazë të nenit 44 të KPRK-s, dhe me pëlqimin e akuzuarit L.V..., dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i **ZAVENDËSOHET** në dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 90 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Konform nenit 79 të KPP-s, koha e kaluar në paraburgim nga data 26.06.2023 deri me datë 24.07.2023të pandehurit i llogaritet në dënimin e shqiptuar.
- IV.** Obligohet i akuzuari që t'ia paguaj të dëmtuarës “Viva Fresh Store” shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 5,588.93 €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** Obligohet i akuzuari që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- VI.** Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rriedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.07.2023, ka ngritur aktakuzë, me numër të lëndës PP.II.nr.992/2023, kundër të akuzuarit L.V...nga fshati Ll..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar dhe publik më datës 24.07.2023, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, i pandehuri L.V..., me mbrojtësin e tij av.Ramadan Leka dhe i dëmtuari A.D.... Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shteti, në këtë seancë, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorës së shtetit, të dëmtuarit dhe mbrojtësist të të pandehurit ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit L.V..., për kryerjen e veprës penale për të cilat akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri L.V..., ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin L.V..., për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin L.V...si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar, i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e saj, dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit L.V... duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit

Lidhur me llogaritjen e paraburgimit gjykata vendosi konform nenit 79 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata lidhur me kërkesën pasurore juridike vendosi konform nenit 462 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

9. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale, gjykata, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP, ka obliguar të pandehurin të paguaj paushallin gjyqësor si dhe konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të detyroj të pandehurin të paguaj taksen për viktimat e krimit (Ligji nr.08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.478/2023, më datën 24.07.2023

Bashkëpunëtore profesionale,
Kadishe Ajvazi Demi

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, të dëmtuarit, mbrojtësit dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli,

NË EMËR TË POPULLIT A K T G J Y K I M

I pandehuri L.V..., i biri i Fadil dhe nënës Nexhmije, e lindur Shkodra, i lindur me datë 28.07.1990, në Gjilan, me vendbanim në fshatin Llashticë, komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, me numër personal 1230155816, me numër të telefonit 049/406-998, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pavërtetuar deri me datë 26.06.2023, në Q.T “Viva Fresh Store”, në njësinë nr.2 në Gjilan, i pandehuri L.V..., në cilësinë e menaxherit, ka keqpërdorur autorizimet e tij që dalin nga kontrata e lidhur me ndërmarrjen “Viva Fresh Store”, me qëllim që vetit apo personit tjetër të i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka dëmtuar kompaninë në vlerë financiare prej 5,588.93 euro, ku gjatë përfaqësimit, apo kujdesit, për interesat pasurore të Viva Fresh Store, nuk i ka përmbushë detyrimet e tij, i ka keqpërdor, ashtu që artikujt e blerë nga konsumatorët, fillimisht janë regjistruar nga i njëjti, por për të përvetësuar paratë për nevojat e tij personale, nuk e kishte printuar fare kuponin fiskal, që ishte detyrë dhe obligim i tij, por kishte përdorur kartelën “0” për të shlyer artikujt që ishin blerë për konsum dhe këto mjete financiare, i kishte përvetësuar për nevoja personale apo përfitime personale, me ç rast të dëmtuarës ndërmarrjes “Viva Fresh Store”, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të 5,588.93 euro.

-Me çka ka kryer veprën penale, keqpërdorimi i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s. Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 40, 42, 44, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK-s, si dhe 364 të KPP, të akuzuarin.

E G J Y K O N

I. Të akuzuarin **L.V...**për veprën penale keqpërdorimi i besimit nga neni 330 paragrafi 2 të KPRK-s, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,

II. Në bazë të nenit 44 të KPRK-s, dhe me pëlqimin e akuzuarit L.V..., dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i **ZAVENDËSOHET** në dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 90 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Konform nenit 79 të KPP-s, koha e kaluar në paraburgim nga data 26.06.2023 deri me datë 24.07.2023të pandehurit i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

IV. Obligohet i akuzuari që t’ia paguaj të dëmtuarës “Viva Fresh Store” shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 5,588.93 €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Obligohet i akuzuari që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimin në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

VI. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Përfundoi në ora 11,20 minuta.

Sek. juridike,

Vërtetojnë

Gjykatësi